



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 515/8 Prot.

Tiranë, më 28.03.2022

VENDIM

Nr. 33, datë 28.03.2022

PËR

**NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË MODULEVE SPORTE DIMËRORE,  
SPORTE UJORE DHE KAMPINGU VEROR/MALOR**

Në zbatim të nenit 38 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”; të VKM-së nr.57 datë 29.1.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në RSh”; të VKM-së nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të nenit 20 të Statutit të UST-së, miratuar me Urdhërin e MAS nr. 545, datë 26.1.2022; në nenin 60 të Rregullores së UST-së; si dhe duke marrë në konsideratë “Kërkesën për trajtim të veçantë të moduleve Sporte Dimërore, Sporte Ujore dhe Kamping Veror/Malor” të Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit me nr.524 Prot., datë 28.03.2022 të miratuar nga Dekani i FVFR, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 28.3.2022

**VENDOSI:**

1. Modulet Sporte Dimërore, Sporte Ujore dhe Kampingu Veror/Malor të cilat klasifikohen si module të lëndëve karakterizuese të kategorisë “C”, të zhvillohen në terrene specifike dhe në prani të vazhdueshme të instruktorit.
2. Modulet Sporte Dimërore, Sporte Ujore dhe Kampingu Veror/Malor të zërthehen në elementet mësimorë si vijon:
  - Leksione = 0,4 ECTS; Seminare = 01 ECTS; Outdoors = 2,5 ECTSKonvertimi në ngarkesë mësimore do të jetë si më poshtë:
  - 4 orë leksione;
  - 1 orë seminar;
  - 50 Praktika Profesionale
3. Ky vendim është i vlefshëm për të gjitha rastet e tjera të ngjashme në UST.
4. Ky vendim i përcillet Dekanateve të UST për zbatim.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**PROF.DR. AGRON KASA**

